

FINANCA

Buletini Maja | GUSHT 2026



MINISTRI PETRIT MALAJ: TË ARDHURAT PUBLIKE JANË RRI TUR ME 31% NË TRE VITET E FUNDIT

Ministri i Financave, z. Petrit Malaj, informoi përmes një komunikimi publik se të ardhurat buxhetore janë rritur me 31% gjatë tre viteve të fundit, ndërsa në 7-mujorin e parë të vitit 2026 janë shtuar me rreth 515 milionë euro,

krahasuar me 7-mujorin e vitit 2025. Kjo rritje, sipas z. Malaj, tregon një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe formalizim të ekonomisë shqiptare. Ministri theksoi se rritja e të ardhurave nuk ka ardhur si rezultat i rritjes së taksave, por falë miradministritimit tatimor dhe doganor. Synimi është që të ardhurat publike të rriten me 1.2 miliardë euro deri në fund të vitit, të ardhura që do të shërbejnë për më shumë investime dhe për përmirësimin e shërbimeve publike.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRIA E FINANCAVE RAPORTON MBI ECURINË E OBJEKTIVAVE 2026 DHE PRIORITETET PËR VITIN E ARDHSHËM

Ministria e Financave raportoi në takimin me Kryeministrin Rama mbi ecurinë e objektivave për vitin aktual dhe prioritetet për vitin e ardhshëm. Vijimi i forcimit të financave publike, përmirësimi i administritimit fiskal dhe buxhetor, si dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me standardet e Bashkimit Evropian mbeten ndër prioritetet kryesore të Ministrisë së Financave. Në fokus të

punës do të jenë modernizimi i administratës tatimore dhe doganore përmes digjitalizimit, rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë fiskale, përmirësimi i menaxhimit të borxhit dhe garantimi i një procesi buxhetor të orientuar drejt rezultateve. Njëkohësisht, Ministria do të vijojë angazhimin për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të integritimit evropian, si dhe për forcimin e mëtejshëm të kuadrit institucional dhe ligjor të financave publike.

► LEXO MË SHUMË



PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-KORRIK 2026

Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Korrik 2026, arritën në rreth 484.6 miliardë lekë, një realizim në masën 100% të planit të periudhës. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2025, të ardhurat u rritën me rreth 51.1 miliardë lekë ose 11.8 % më shumë, një realizim në masën 58.9 % të planit vjetor sipas buxhetit fillestar dhe 57.5% sipas Aktit Normativ nr.2. Shpenzimet e përgjithshme publike, për periudhën 7-mujore të vitit 2026, arritën në rreth 433.2 miliardë lekë, me një realizim në masën 98.2% të planit të periudhës. Krahasuar me 7-mujorin 2025 ky zë ka rezultuar 7.8% më i lartë ose rreth 31.3 miliardë lekë më shumë. Në terma vjetorë, shpenzimet e përgjithshme për 7-mujorin e vitit 2026 u realizuan në masën 48.8% të planit vjetor sipas Buxhetit Fillestar dhe 47.8% të planit vjetor sipas Aktit Normativ nr. 2.

► LEXO MË SHUMË



PUSHTETI VENDOR, 15.7 MILIARDË LEKË MË SHUMË TË ARDHURA NË JANAR-QERSHOR 2026

Pushteti vendor ka regjistruar rritje të ndjeshme të të ardhurave gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2026, duke krijuar më shumë mundësi për investime dhe shërbime më cilësore për qytetarët. Këto të ardhura kanë arritur në masën 34.8 miliardë lekë, rreth 15.7 miliardë lekë ose rreth 82% më shumë se vlera e të ardhurave



5.9 MILIARDË LEKË TË ARDHURA NGA TAKSA E PASURISË NË 6-MUJORIN E PARË 2026

Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksa e pasurisë kanë arritur në 5.9 miliardë lekë në 6-mujorin e parë të vitit 2026 ose 25% më shumë krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2025. Të dhënat janë publikuar nga Drejtoria e Pushtetit

► LEXO MË SHUMË

Vendor në Ministrinë e Financave, referuar monitorimit 6-mujor të realizimit të të ardhurave nga pushteti vendor. Bashkitë me rritjen më të madhe të të ardhurave nga taksa e pasurisë, ku përfshihen të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën, taksa mbi truallin, taksa mbi tokën dhe taksa mbi transaksionet mbi pasurinë e paluajtshme, janë bashkia Himarë, Cërrik, Vlorë, Patos, Elbasan dhe Tiranë.


► LEXO MË SHUMË



POLITIKA MOTIVUESE PËR STAFET E ANGZHUARA NË MENAXHIMIN DHE ZBATIMIN E PROGRAMEVE OPERACIONALE IPA III

Politika Motivuese për stafet e angazhuara në menaxhimin dhe zbatimin e Programeve Operacionale IPA III është miratuar për herë të parë në Shqipëri, me aprovimin e Komisionit Europian. Hartuar nën drejtimin e Zyrtarit Kombëtar Autorizues në Ministrinë e Financave, ajo përfshin një numër institucionesh të angazhuara në menaxhimin dhe zbatimin e fondeve IPA III nën menaxhimin indirekt. Politika parashikon një sërë masash motivuese jofinanciare, të shoqëruara edhe me një shtesë të kushtëzuar page për stafet e angazhuara në Programet Operacionale, me synim motivimin dhe ruajtjen e kapaciteteve profesionale të nevojshme për menaxhimin efektiv të fondeve të Bashkimit Europian.

► LEXO MË SHUMË



BUXHETI I EMERGJENCAVE CIVILE ËSHTË RRI TUR NË 5.79 MILIARDË LEKË NË 2026

Në 7 vitet e fundit, buxheti për emergjencat civile është rritur më shumë se 13-fish, nga 430 milionë lekë në vitin 2020, në 5.79 miliardë lekë në vitin 2026. Rritja e qëndrueshme e financimit ka forcuar kapacitetet për përballimin e zjarreve, përmbytjeve, fatkeqësive natyrore dhe situatave të tjera emergjente, duke garantuar më shumë burime për ndërhyrje dhe reagim në terren. Krahas financimit të shtuar në nivel qendror, edhe bashkitë kanë në dispozicion fonde më të larta për përballimin e situatave emergjente në territor. Ndërkohë, rezultatet shumë të mira fiskale të këtij viti kanë krijuar hapësirën e nevojshme buxhetore për t'iu përgjigjur nevojave të paparashikuara, pa cenuar financimin e prioriteteve të tjera.

► LEXO MË SHUMË

SISTEMI I PËRMIRËSUAR I PULLAVE FISKALE, MË SHUMË SIGURI DHE KONTROLL

Dogana Shqiptare po modernizon sistemin e pullave fiskale përmes një zgjidhjeje të re digjitale, që garanton gjurmueshmëri, monitorim dhe verifikim të produkteve

subjekt akcize. Prej datës 1 korrik 2026, sistemi i ri ka hyrë në zbatim, duke mundësuar që çdo pullë fiskale të pajiset me identifikues unik digjital, ndërsa produktet të gjurmohen elektronikisht nga prodhimi ose importi deri në treg. Përmes aplikacionit ALBTrace Connect, konsumatorët mund të verifikojnë autenticitetin e produktit me telefon. Sistemi i

ri sjell më shumë siguri, më shumë transparencë dhe më shumë kontroll. Sistemi forcon luftën kundër kontrabandës, falsifikimit dhe evazionit fiskal, duke rritur mbrojtjen e konsumatorit dhe transparencën në treg.

► LEXO MË SHUMË



VIJON RIMBURSIMI I INDIVIDËVE PËR DIVA 2025

Administrata Tatimore ka vijuar procesin e rimbursimit të individëve në kuadër të Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave DIVA 2025. Rreth 39,940 individë përfituan në

periudhën e parë të muajit gusht rimbursimin mbi tatimin e mbipaguar dhe zbritjen për fëmijët. Vlera totale e rimbursimit për këta individë arriti në rreth 6.4 milionë euro. Procesi i rimbursimit do të vijojë në çdo kohë, bazuar në kërkesat që individët paraqesin në llogarinë e tyre në sistemin e-Filing. Me qëllim përsheptimin e këtij

procesi, Administrata Tatimore ka publikuar edhe një udhëzues për plotësimin e të dhënave të llogarisë bankare në e-Filing dhe fton të gjithë individët që rezultojnë me tatim të mbipaguar ta plotësojnë këtë informacion sa më parë.

► LEXO MË SHUMË

KOMPENSIMI ME 10% I FERMERËVE PËR SHITJET E PRODUKTEVE BUJQËSORE PËRMES AUTOFATURËS

8.3 milionë euro është shuma totale e kompensimit 10% për fermerët, përmes skemës së autofaturës, gjatë periudhës 1 korrik – 10 gusht 2026. Gjatë kësaj

periudhë janë dorëzuar 3,366 aplikime online, nga të cilat 1,120 janë miratuar, ndërsa 2,138 aplikime janë në proces shqyrtimi. Administrata Tatimore fton fermerët që plotësojnë kriteret të aplikojnë përmes platformës e-Filing, për të përfituar kompensimin që u takon. Për asistencë gjatë aplikimit, fermerët mund të paraqiten

pranë zyrës së shërbimit të tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse ose të kontaktojnë adresën e posaçme të e-mailit: **info.fermeret@tatime.gov.al**.

► LEXO MË SHUMË

